VENDIM
Nr. 11, datë 26.2.2014

PËR MIRATIMIN E UDHËZIMIT "MBI PLANET E RIMËKËMBJES"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe të nenit 57, pika 4 dhe 5 të nenit 58, shkronja "c", nenit 66/1 dhe nenit 73, pika 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Të miratojë udhëzimin "Mbi planet e rimëkëmbjes", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të tij në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

UDHËZIM
MBI PLANET E RIMËKËMBJES

KREU 1
KËRKESA TË PËRGJITHSHME DHE STRUKTURA E PLANEVE TË RIMËKËMBJES

1. Objekti

1) Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i parimeve themelore dhe kërkesave mbikëqyrëse mbi strukturën dhe përmbajtjen e planeve të rimëkëmbjes së bankave (këtu e më poshtë në këtë udhëzim do të quhen për thjeshtësi "plane"), si dhe raportimin e tyre pranë Bankës së Shqipërisë.

2. Subjektet

1) Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të përcaktuara si banka me rëndësi sistemike nga administratori përkatës i Bankës së Shqipërisë për qëllime të këtij udhëzimi, bazuar në propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes;

2) Departamenti i Mbikëqyrjes njofton bankat, të cilat do të jenë subjekte të këtij udhëzimi.

3. Baza juridike

Ky udhëzim hartohet në bazë dhe për zbatim të:

- nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe

- nenit 57, pikat 4 dhe 5 të nenit 58, shkronja "c", nenit 66/1 dhe nenit 73, pika 4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

4. Parime bazë

1) Plani i rimëkëmbjes është një dokument që paraqet masat e mundshme të rimëkëmbjes, që mund të ndërmarrin vetë bankat për të rikthyer në normalitet gjendjen e tyre financiare dhe siguruar vazhdimësinë e veprimtarisë në përgjigje të skenarëve që mund të cenojnë këtë vazhdimësi. Banka i koncepton këto masa si zgjidhje me natyrë të jashtëzakonshme, të cilat nuk ndërmerren përgjatë veprimtarisë normale të biznesit. Planet e rimëkëmbjes synojnë të reduktojnë probabilitetin e dështimit të bankave sistemike.

2) Bankat, në përgatitjen e planeve marrin në konsideratë supozimin bazë, se në këtë proces nuk do të ofrohet mbështetje me fonde publike (fondet e taksapaguesve), duke synuar minimizimin e nevojës për ndërhyrjen e institucioneve shtetërore.

5. Kërkesa të përgjithshme

1) Bankat hartojnë dhe përditësojnë planet e rimëkëmbjes. Përditësimi i planeve bëhet të paktën një herë në vit, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve të mundshme në raport me variantin paraardhës të planit, mbështetur në zhvillimet lidhur me profilin e rrezikut të bankës, kushtet e tregut dhe çdo faktor tjetër që ndikon në masat e rimëkëmbjes, të propozuara në plan.

2) Bankat identifikojnë në këto plane një numër të mjaftueshëm masash rimëkëmbjeje të mundshme për t'u zbatuar, me qëllim përballimin si të goditjeve specifike për to, ashtu edhe të goditjeve me natyrë sistemike. Këto masa duhet të mundësojnë korrektimin e situatave kritike të rënies së nivelit të kapitalizimit dhe gjendjes së likuiditetit, duke synuar rikthimin e bankave në një gjendje të qëndrueshme.

3) Bankat, në rastet kur nuk arrijnë të identifikojnë masa të besueshme rimëkëmbjeje, duhet të pasqyrojnë në plane masat e tjera paraprake që do të ndërmarrin për të përmirësuar aftësinë e tyre për t'u rimëkëmbur.

4) Bankat përcaktojnë në plane proceset përkatëse të drejtimit, kushtet e vënies në zbatim të tyre, dhe procedurat për të siguruar zbatimin në kohë të masave të rimëkëmbjes në rast nevoje.

5) Bankat përcaktojnë një administrator (drejtor ekzekutiv) që duhet të jetë njëkohësisht anëtar i Këshillit Drejtues, i cili është përgjegjës për drejtimin e procesit për përgatitjen e planit brenda bankës, si dhe cilësinë e tij.

6) Bankat, përfshijnë në plane informacionin e nevojshëm për të ndihmuar Bankën e Shqipërisë të sigurojë marrëdhënie efektive me autoritetet që mbikëqyrin bankat mëmë të filialeve apo degëve të bankave të huaja lidhur me procesin e rimëkëmbjes. Banka e Shqipërisë synon bashkëpunimin me këto autoritete në procesin e planifikimit të rimëkëmbjes së bankave, me qëllim marrjen e angazhimit të tyre se bankat mëmë do të jenë në gjendje të përballen efektivisht me situata të mundshme problematike, si dhe të ofrojnë mbështetje me kapital dhe likuiditet për filialet ose degët e tyre sipas nevojës.

6. Struktura e planit

1) Bankat hartojnë planet duke e organizuar informacionin në dy seksione kryesore. Seksioni i parë do të jetë një përmbledhje e planit. Seksioni i dytë do të parashtrojë përmbajtjen specifike të planit.

7. Përmbledhja e planit

1) Bankat hartojnë përmbledhjen e planit, duke siguruar një bazë të tillë informacioni që Banka e Shqipërisë të kuptojë qartë aftësinë e tyre për t'u rimëkëmbur nga një situatë problematike dhe ta lejojë

atë të vlerësojë në mënyrë të përmbledhur masat e rimëkëmbjes.

2) Bankat përfshijnë këto elemente kryesore në seksionin e përmbledhjes së planit:

a) Konfirmimi se Këshilli Drejtues i bankës ka shqyrtuar dhe miratuar planin dhe emrin/pozicionin e personit përgjegjës për planin, sipas kërkesave të paragrafit 5 të pikës 5 të këtij udhëzimi;

b) Një përmbledhje të analizës strategjike të bankës;

c) Një përmbledhje të masave të mundshme të rimëkëmbjes së bankës dhe aftësisë aktuale të saj për t'u rimëkëmbur nga një situatë ekstreme;

d) Një përmbledhje të çështjeve dhe të veprimeve korrektuese që bankat dhe Banka e Shqipërisë kanë identifikuar për të përmirësuar masat e rimëkëmbjes (ose kapacitetin për t'u rimëkëmbur);

e) Një përshkrim të çdo ndryshimi të rëndësishëm ose veprimi të ndërmarrë që nga paraqitja e fundit e planit në Bankën e Shqipërisë;

f) Një përmbledhje të strategjisë së komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.

KREU 2
PËRMBAJTJA SPECIFIKE E PLANIT

8. Përmbajtja specifike e planit

1) Bankat përfshijnë në përmbajtjen specifike të planit elementet e paraqitura në shkronjat "a" deri në "f" të kësaj pike. Bankat raportojnë këtë format, së bashku me shpjegime të tjera që i gjykojnë të nevojshme në zbatim të kërkesave të këtij udhëzimi, në seksionin e dytë të dokumentit që dorëzohet pranë Bankës së Shqipërisë.

a) Drejtimi

Ky element paraqet kuadrin e përgjithshëm të drejtimit të proceseve të zhvillimit dhe zbatimit të mundshëm të planit në bankë.

Çështja	Kërkesat minimale
Zhvillimi i planit	- Emri i administratorit (drejtorit ekzekutiv) të bankës që është përgjegjës për drejtimin e procesit për përgatitjen e planit brenda bankës, si dhe cilësinë e tij. - Përshkrimi i funksioneve përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e planit në bankë. - Lista e drejtuesve ekzekutivë që do të përfshihen në secilin nga veprimet e rimëkëmbjes dhe rolet që do të luajnë. - Përshkrimi i proceseve të vendimmarrjes lidhur me vënien në zbatim të planit. - Përshkrimi i mënyrës se si është integruar plani në kuadrin e përgjithshëm të drejtimit të bankës dhe administrimit të rrezikut. - Konfirmimi se banka ka ngritur një kuadër drejtimi dhe kontrolli të brendshëm të përshtatshëm për të siguruar se informacioni është relevant dhe me cilësinë e duhur.
Politikat dhe procedurat për miratimin	- Konfirmimi që plani është shqyrtuar nga funksioni i Kontrollit të Brendshëm, Komiteti i Rrezikut ose auditori i jashtëm, përfshirë një përmbledhje të komenteve dhe të rekomandimeve të tyre. - Vendimi i Këshillit Drejtues të bankës, me anë të të cilit është miratuar plani. Këshilli Drejtues miraton planin çdo herë që ky ndryshon në përputhje me rekomandimet e Bankës së Shqipërisë apo si rezultat i përditësimeve periodike.
Marrëdhëniet brenda grupit/aktiviteti bankar ndërkufitar	Kur banka është pjesë e një grupi të huaj: - Përshkrimi i masave të ndërmarra për të siguruar koordinimin dhe konsistencën midis planeve në nivel grupi dhe në nivel individual. - Përshkrimi se si banka do të sigurojë se informacioni i nevojshëm për zbatimin e mundshëm të masave të rimëkëmbjes do të vihet në dispozicion për vendimmarrje në situata problematike, në mënyrë të besueshme dhe të shpejtë. Ky informacion përfshin, por nuk kufizohet në informacionin që duhet të sigurohet nga filiali/dega e bankës së huaj për Bankën e Shqipërisë, informacionin që do të shkëmbehet midis filialit/degës së bankës së huaj dhe bankës mëmë ose shoqërisë zotëruese etj.

b) Analiza strategjike

Ky element paraqet një analizë të përmbledhur të strukturës dhe veprimtarisë së bankës dhe harmonizimin e planit me strategjinë e përgjithshme të saj.

Çështja	Kërkesat minimale
Pamje e përgjithshme e bankës	- Përshkrimi i strukturës së përgjithshme të bankës ose grupit, duke treguar qartë entitetet ligjore sipas madhësisë së aktiveve. - Përshkrimi i strategjisë së përgjithshme të biznesit dhe të rrezikut, dhe harmonizimit të planit me këto strategji. - Përshkrimi i modelit të biznesit dhe veprimtarive kryesore. - Përshkrimi i linjave kryesore të biznesit dhe funksioneve kritike. - Informacion mbi depozitat e mbuluara nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe depozitat e pambuluara. - Përshkrimi i marrëdhënieve me banka ose subjekte të tjera, për sa u përket ekspozimeve të rëndësishme ose detyrimeve ndaj kundërpartive kryesore.
Marrëdhëniet brenda grupit/aktiviteti bankar ndërkufitar	Kur banka është pjesë e një grupi të huaj, ajo siguron shpjegimet e nevojshme mbi pozicionin e filialit/degës së bankës së huaj në Shqipëri si pjesë e grupit, duke përfshirë: - Përmbledhjen e aktivitetit të biznesit në nivel grupi, shoqëruar me të dhëna mbështetëse, si dhe pozicionimin dhe peshën përkatëse të bankës brenda grupit.

	- Përshkrimin e ekspozimeve materiale të bankës brenda grupit, marrëdhënieve të financimit dhe çdo marrëveshjeje tjetër për mbështetje financiare. - Përshkrimin e flukseve të kapitalit të bankës brenda grupit dhe garancitë brenda grupit. - Përshkrimin e varësive operacionale të bankës brenda grupit, përfshirë një shpjegim të mënyrës se si janë organizuar dhe si ofrohen brenda grupit funksionet mbështetëse, për shembull, në lidhje me teknologjinë e informacionit, administrimin e rrezikut, auditimin etj. - Përshkrim mbi mënyrën se si e trajton plani i rimëkëmbjes së grupit, në rastet kur kjo është e aplikueshme, veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

c) Masat e mundshme të rimëkëmbjes

Ky element paraqet një kuadër konsistent për raportimin e masave të rimëkëmbjes të propozuara nga banka.

Çështja	Kërkesat minimale
Përshkrimi i masave	- Përshkrimi i çdo mase rimëkëmbjeje, përfshirë hapat për zbatimin dhe kohën e nevojshme.
Ndikimi	Për çdo masë rimëkëmbjeje: - Përshkrimi i efektivitetit të zbatimit të masës, shoqëruar me të dhëna mbështetëse, përfshirë përfitueshmërinë, profilin e rrezikut, operacionet dhe flukset e parasë të bankës. - Shpjegimi i ndikimit sasior dhe cilësor mbi kapitalin dhe likuiditetin dhe përshkrimi i supozimeve përkatëse. - Përshkrimi i ndikimit sasior dhe cilësor të masës së rimëkëmbjes në operacionet e biznesit dhe funksionet mbështetëse. - Përshkrimi, në rastet kur është i aplikueshëm, i ndikimit në vlerësimin e jashtëm të kredisë të bankës, pas zbatimit të masës së rimëkëmbjes.
Konsiderata mbi zbatimin	Për çdo masë rimëkëmbjeje: - Vlerësimi i kohës së nevojshme për të përftuar efektet e masës së rimëkëmbjes. - Vlerësimi i realizueshmërisë nga pikëpamja e rreziqeve (ligjore, rregullative, operacionale, të biznesit, financiare, reputacionale), që përbëjnë pengesë për zbatimin e suksesshëm. - Përshkrimi dhe plani për të zbutur/shmangur rreziqet e identifikuara lidhur me zbatimin e masës. - Përshkrimi i varësive dhe i supozimeve, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në varësinë e bankës nga banka mëmë ose aksionerët, ofruesit e shërbimeve, palë të tjera të treta etj. - Përshkrimi i proceseve të drejtimit dhe të kontrollit lidhur me masën e rimëkëmbjes, duke shpjeguar se cili komitet ekzekutiv mban përgjegjësi për masën nga pikëpamja operacionale.
Besueshmëria	Për çdo masë rimëkëmbjeje, duhet të kryhet një analizë për të demonstruar besueshmërinë e saj, duke përfshirë vlerësimin e elementeve të mëposhtme: - Efektiviteti i mundshëm në përgjigje të tensioneve specifike dhe në nivel tregu. - Faktorët që mund të reduktojnë probabilitetin e suksesit dhe si mund të zbuten/shmangen këta faktorë. - Përshkrimi nëse banka e ka zbatuar ndonjëherë me sukses këtë masë rimëkëmbjeje. - Përshkrimi i rrethanave në të cilat masa e rimëkëmbjes nuk do të ishte në dispozicion për t'u zbatuar nga banka.
Integrimi me proceset ekzistuese	Për çdo masë rimëkëmbjeje: - Si është integruar plani në kuadrin e administrimit të rrezikut të bankës. - Si lidhet plani me kuadrin ekzistues dhe proceset e provave të rezistencës lidhur me kapitalin dhe likuiditetin. - Çfarë supozimesh janë marrë në konsideratë lidhur me financimin nga Banka e Shqipërisë. - Detaje mbi proceset e ndërmarra për të siguruar mbështetjen e planit nga Këshilli Drejtues i bankës.
Treguesit e vënies në zbatim dhe zbatimi i planit të rimëkëmbjes	- Përcaktimi dhe përshkrimi me shembuj mbështetës i treguesve sasiorë dhe cilësorë, përkeqësimi i të cilëve do të nxisë zbatimin e masave të rimëkëmbjes. Bankat përcaktojnë këta tregues, duke synuar arritjen e një kapaciteti të mjaftueshëm për të sinjalizuar nevojën për të vënë në zbatim planin. - Përshkrimi i drejtimit dhe i kontrollit të bankës dhe të procesit të vendimmarrjes **deri në** dhe **në vijim** të thyerjes së treguesve të vënies në zbatim. - Përshkrimi se kur mund të nisin veprimet e rimëkëmbjes dhe në çfarë rrethanash, nëse ka të tilla, masat e rimëkëmbjes mund të vihen në zbatim pa thyerjen e treguesve të vënies në zbatim. - Përshkrimi i drejtimit dhe i kontrollit, dhe të procesit të vendimmarrjes në vijim të vendimit për të vënë në zbatim planin e rimëkëmbjes. - Përmbledhja e angazhimit të pritshëm me palët e tjera jashtë bankës, duke përfshirë Bankën e Shqipërisë, Agjencinë e Sigurimit të Depozitave dhe Ministrinë e Financave. - Lista e stafit kyç të bankës të përfshirë në procesin e vendimmarrjes.
Marrëdhëniet brenda grupit/aktiviteti bankar ndërkufitar	Kur banka është pjesë e një grupi të huaj: - Përshkrimi, në rastet kur është i aplikueshëm, i rolit të bankës mëmë/shoqërisë zotëruese lidhur me zbatimin e çdo mase rimëkëmbjeje. - Përshkrimi i kushteve dhe i nivelit të mbështetjes me kapital dhe likuiditet nga ana e

	bankës mëmë/shoqërisë zotëruese.

d) Mbështetja nga Banka e Shqipërisë

Ky element paraqet analizën e bankës mbi nevojat për mbështetje me likuiditet nga Banka e Shqipërisë dhe aftësinë e saj për të shfrytëzuar këtë mbështetje.

Çështja	Kërkesat minimale
Plani për të përdorur mbështetjen me likuiditet nga Banka e Shqipërisë	Bankat duhet të përgatisin një analizë se si do të aplikojnë për shfrytëzimin e mbështetjes me likuiditet nga Banka e Shqipërisë dhe/ose banka qendrore të huaja, ku mund të kenë akses në situata problematike. Në këtë kuadër, bankat duhet të vlerësojnë: - Rrethanat në të cilat mund të kërkojnë mbështetje me likuiditet nga Banka e Shqipërisë. - Një vlerësim të faktorëve që mund të ndikojnë aftësinë e bankës për të shfrytëzuar mbështetjen me likuiditet nga Banka e Shqipërisë, përfshirë analizën e aktiveve që mund të përdoren për këtë qëllim dhe sasisë së likuiditetit që mund të përftohet bazuar në këto aktive.

e) Masat e mundshme të shitjes

Ky element paraqet në mënyrë më të hollësishme masat e mundshme të shitjes në dispozicion të bankës. Këto janë masa rimëkëmbjeje që parashikojnë shitjen e aktiveve të bankës apo linjave të saj të biznesit.

Çështja	Kërkesat minimale
Masat e shitjes	Bankat duhet të përgatisin planet përkatëse për shitjen e mundshme të aktiveve/linjave të biznesit. Në këtë kuadër bankat do të sigurojnë informacionin e mëposhtëm: - Blerësit e mundshëm; - Përshkrimi i procesit të drejtimit dhe kontrollit për miratimin e transaksioneve; - Komente mbi çështje të mundshme lidhur me konkurrencën; - Përshkrimi i pengesave të mundshme ligjore; - Vlerësimi i implikimeve me natyrë rregullative dhe tatimore; - Vlerësimi i çështjeve lidhur me burimet njerëzore dhe pensionet; - Shpjegimet përkatëse mbi procesin e diligjencës dhe konfirmimi se nuk do të ketë pengesa në shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në shkëmbimin e informacionit me Bankën e Shqipërisë, blerësit potencialë të aktiveve etj.; - Shpjegimi nëse banka ka konsideruar më parë mundësinë e shitjeve të tilla dhe përshkrimin e rezultateve të këtyre tentativave.

f) Plani i komunikimit

Ky element paraqet planin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, për të shoqëruar masat e rimëkëmbjes, duke përmbledhur çështjet që duhet të konsiderohen gjatë zbatimit të këtyre masave për të parandaluar dyshimet lidhur me vijueshmërinë e veprimtarisë së bankës dhe për të ruajtur besimin e tregjeve dhe palëve të tjera të interesit.

Çështja	Kërkesat minimale
Plani i komunikimit	- Përshkrimi i procesit të komunikimit të brendshëm: për punonjësit e bankës; - Përshkrimi i procesit të komunikimit të jashtëm: për aksionerët, autoritetet mbikëqyrëse, kundërpartitë, tregjet financiare, investitorët, depozituesit dhe publikun e gjerë; - Përshkrimi i masave që do të ndërmerren për të administruar reagimet e mundshme negative të tregut.

KREU 3
KËRKESA RAPORTUESE DHE MBIKËQYRËSE

9. Kërkesa raportuese dhe mbikëqyrëse

1) Bankat paraqesin planet pranë Bankës së Shqipërisë çdo vit, jo më vonë se fundi i tremujorit të parë të vitit.

2) Banka e Shqipërisë vlerëson përputhshmërinë me kërkesat e këtij udhëzimi, realizueshmërinë dhe besueshmërinë e planeve të paraqitura nga bankat.

3) Banka e Shqipërisë zhvillon një dialog të vazhdueshëm me bankat, si dhe kryen të gjitha vlerësimet e nevojshme në kuadrin e mbikëqyrjes nga jashtë dhe në vend, për t'u siguruar efektivisht mbi aftësinë e tyre për t'u rimëkëmbur në rast nevoje dhe nivelin e gatishmërisë së tyre operacionale.

4) Banka e Shqipërisë u komunikon bankave rekomandimet e nevojshme për trajtimin e mangësive të identifikuara dhe përmirësimin e planeve, përcakton afatet për pasqyrimin e këtyre rekomandimeve, si dhe monitoron zbatimin e tyre.

10. Masa parandaluese dhe ndëshkimore

1) Banka e Shqipërisë, kur konstaton mosrespektimin nga bankat të detyrimeve të këtij udhëzimi dhe/ose rekomandimeve të saj për përmirësimin e planeve, zbaton masat administrative, mbikëqyrëse, parandaluese dhe ndëshkimore, të parashikuara në nenet 74 deri në 81, dhe në nenin 89 të ligjit "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

11. Të fundit

1) Bankat paraqesin pranë Bankës së Shqipërisë planet e para të hartuara në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi, jo më vonë se fundi i tremujorit të parë të vitit 2015.

2) Bankat, gjatë periudhës deri në paraqitjen e planeve, sipas kërkesave të paragrafit 1 të kësaj pike, njoftojnë Bankën e Shqipërisë mbi ecurinë e procesit në secilin gjashtëmujor të vitit 2014.